1.	Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare	5
2.	Studime Ndërkombëtare të Sigurisë (2 herë)	10
3.	Politika e Jashtme dhe Veprimtaria Diplomatike	5

Totali për ciklin e dytë: 25 pikë

III. Mentorim dhe pjesëmarrje në komisione akademike

- Mentor i 5 tezave të magjistraturës: 10 pikë
- Anëtar në 12 komisione për mbrojtje të magjistraturës: 12 pikë
- Anëtar në një komision të doktoraturës: 3 pikë

Totali i mentorimit: 25 pikë

IV. Aktiviteti shkencor dhe kërkimor

- Pjesëmarrje në 7 konferenca shkencore: 28 pikë

1. “E ardhmja e Projektit Evropian dhe perspektiva e tij globale”
Bruksel, Gusht 2015

2. Southeast Europe Forum (SEEF) – George C. Marshall Center
Garmisch-Partenkirchen, 29 Qershor – 2 Korrik 2021

3. “The Future of the Western Balkans after the Russian Aggression on
Ukraine”
24 Qershor 2024

4. Konferenca Ndërkombëtare: “Towards a Secure Euro-Atlantic Area in a
Globalized World: The Security – Rule of Law Nexus”
Shkup, Qershor 2025
(Folës dhe moderator paneli)

5. “Political Transformations in North Macedonia”
Universiteti i Tetovës, Mars 2024

6. “The Politics of Environmental Integrity”
Universiteti i Tetovës, Prill 2025

7. “The Rule of Law and Reforms in EU Aspirant Countries”
Universiteti Mesdhetar i Tiranës, 2025

- 5 artikuj shkencorë ndërkombëtarë: 30 pikë

6. Fatmir Xheladini – Konflikti në Ukrainë dhe sfidat për bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore, Liber tematik, Botuar nga Qendra Për paqë dhe komunikim Trnaskulturorë, Universiteti i Tetovës, 2025

7. Fatmir Xheladini – Identiteti dhe Siguria: Ndërthurja e Perceptimit, Konfliktit dhe Politikës. Revista Centrum 23-2025 UDC 327.51

8. Fatmir Xheladini – Ndërtimi i shtetit në kontekst të brishtë – Marrëveshja e Ohrit dhe integrimi evropian i Maqedonisë së Veriut, European Journal of Economics, Law and Social Sciences. European Journal of Economics, Law And Social Sciences, Vol.9. 2

9. Fatmir Xheladini – Siguria e përbashkët si shtyllë e integritit evropian – rasti i Maqedonisë së Veriut, International Journal of Social Sciences Visions vol.1/2025

10. Fatmir Xheladini – Integrimi dhe stabiliteti – Rasti i Maqedonisë së Veriut, Joornal for peacebuilding and transcultural communication. Vol.5 9/10

Totali për aktivitetin shkencor: 58 pikë

V. Aktivitetet me interes të gjerë publik dhe përfaqësim diplomatik

- Angazhime institucionale dhe diplomatike (13 pozita dhe përfaqësime të shënuara në pjesën e referatit të këtijë recenzi): 78 pikë

Totali për angazhime publike dhe diplomatike: 78 pikë

Përmbledhje finale e pikëve

- Aktiviteti mësimor: 110 pikë

- Aktiviteti shkencor/kërkimor: 58 pikë

- Konferenca shkencore: 28 pikë

- Aktivitetet publike e diplomatike: 78 pikë

TOTAL I PËRGJITHSHËM: 284.00 pikë

Tetovë, 2025

Komisioni recensues

1. Prof. Dr. Kristaq Xharro, Kryetar

2. Prof. Dr. Safet Emruli, anëtar

3. Prof. Dr. Agon Demjaha , anëtar

REFERAT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIN MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE DHE DIPLOMACIA (5.06.00.06 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË FAKULTETIN JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18), nenit 32, 33, 34, 35 dhe 36 të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, dhe Konkursit për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Diplomacia (5.06.00.06 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) të shpallur më 1. VII. 2025 në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më 10. VII. 2025, solli Vendim me nr. 13-371/3 të datës 10. VII. 2025, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

- 1. Prof. dr. Ylber SELA** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës,
- 2. Prof. dr. Drita MAMUTI-FAZLIA** (anëtare) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës,
- 3. Prof. dr. Bashkim SELMANI** (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, sjellim këtë

RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Diplomacia (5.06.00.06 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në afatin e paraparë është paraqitur vetëm kandidati:

Prof. dr. Shefik Shehu

1. Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidati Shefik Shehu ka lindur më 6. VII. 1978 në fshatin Veleshtë, Strugë, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa atë të mesëm në Shkup. Në vitin 1998, Shefik Shehu filloi studimet universitare në Universitetin Ndërkombëtar të Malajzisë (IUM) në Kuala Lumpur. Ai ndoqi programi studimor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, duke i përfunduar studimet me sukses të dalluar në vitin 2002.

Pas suksesit të tij universitar, Shefik Shehu vazhdoi studimet e ciklit të dytë në Institutin për Studime Evropiane dhe Ndërkombëtare në Hungari. Teza e tij kërkimore „Marrëveshja e Ohrit: Rruga drejt Integritimit apo Shpërbërjes?“, ofroi një analizë të thelluar të marrëdhënieve ndëretnike dhe strukturave institucionale në Ballkanin Perëndimor pas konfliktit. Kjo punë shfaqti qasjen e tij analitike dhe ndërdisiplinore ndaj çështjeve komplekse rajonale.

Kandidati mr. Shefik Shehu studimet e doktoraturës i regjistroi në Institutin për Studime të Mbrojtjes dhe Paqes në kuadër të Fakultetit Filozofik të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ në Shkup. Në korrik 2015, ai mbrojti me sukses disertacionin: „Maqedonia dhe strategjia evropiane e sigurisë: Roli i Maqedonisë në sigurinë e Bashkimit Evropian“. Kjo punë shkencore trajtoi me përpikëri dimensionet gjeopolitike dhe sfidat e integritimit për vendet e Ballkanit, e në veçanti atë të Republikës së Maqedonisë së Veriut brenda arkitekturës së sigurisë së Bashkimit Evropian, duke forcuar më tej ekspertizën e tij në një fushë shumë të rëndësishme dhe komplekse.

Në vitin 2008, Shefik Shehu bëhet pjesë e Universitetit të Tetovës. Angazhohet në procesin arsimor në cilësinë e asistentit në Fakultetin Juridik dhe paralelisht si pjesë e Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Ai themeloi dhe drejtoi Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë, duke e shndërruar në një njësi thelbësore për përgatitjen e studentëve për tregun global të punës. Nga viti 2009, ai udhëhoqi Zyrën për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe më pas Zyrën për Arsim, ku modernizoi kurrikulat dhe forcoi themelet për ndërkombëtarizim.

Si koordinatori i projekteve TEMPUS, Shefik Shehu bashkëpunoi me universitete elitare evropiane për akreditimin e dhjetëra programeve studimore. Ai ishte autor i programit studimor të parë të Shkencave Politike në Universitetin e Tetovës (në gjuhën shqipe në 2011 dhe atë angleze në 2012) duke demonstruar një qasje strategjike për të rritur konkurrueshmërinë ndërkombëtare të Universitetit të Tetovës.

Në vitin 2017, si Drejtues i Zyrës për Menaxhimin e Projekteve, ai rriti ndjeshëm pjesëmarrjen e universitetit në programet e BE-së, veçanërisht në rrjetin CEEPUS dhe Erasmus+. Një arritje kulminante ishte përfshirja e Universitetit të Tetovës në Aleancën AURORA (2019), një nga 17 aleancat fillestare të universiteteve evropiane, duke e pozicionuar institucionin si një partner të besueshëm në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Gjatë kësaj kohe, ai inicioi edhe bashkëpunime transatlantike përmes programeve Fulbright dhe Peace Corps.

I emëruar Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar në vitin 2019, Prof. dr. Shefik Shehu thelloi ndërkombëtarizimin e institucionit. Ai forcoi lidhjet me rrjetet rajonale si Asociacioni i Universiteteve Europiane (EUA), Shoqata e Universiteteve të Ballkanit (BUA) dhe Rrjeti i Universiteteve të Detit të Zi (BSUN), si dhe me të gjitha universitetet publike shqiptare.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve për zhvillim strategjik dhe zgjerim ndërkombëtar, vlen të theksohet përfshirja e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës në World Directory of Medical Schools (WDOM), duke siguruar sponsorizim nga ECFMG. Kjo arritje thelbësore mundësoi njohjen globale të diplomave të mjekësisë dhe aksesin e të diplomuarve në tregjet ndërkombëtare të punës, përfshirë SHBA-në. Nën drejtimin e tij të sektorit të marrëdhënieve ndërkombëtare, Universiteti i Tetovës realizoi zgjerimin më të madh të marrëveshjeve Erasmus+, duke e transformuar programin në një mekanizëm për zhvillimin e studentëve dhe promovimin e Universitetit të Tetovës anë e mbanë rajonit dhe Europës.

Përtej bashkëpunimeve institucionale, Prof. dr. Shefik Shehu i dha një theks të rëndësishëm ndërtimit të diplomacisë akademike në terren, duke e transformuar Universitetin e Tetovës në një hapësirë takimi të gjallë për diplomatë, ambasadorë dhe përfaqësues ndërkombëtarë. Nën kujdesin e tij, Universiteti i Tetovës priti rregullisht ambasadorë të akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilët u angazhuan në ligjërata publike, panele akademike dhe aktivitete shkencore. Ai ishte gjithashtu nismëtar i themelimit të Këndit Amerikan, një qendër e rëndësishme për diplomacinë publike, njëherit një platformë dinamike për dialog dhe ndërveprim ndërmjet studentëve, stafit akademik dhe kulturës amerikane, brenda ambienteve të Universitetit të Tetovës.

Si rezultat i drejtpërdrejtë i aktivitetit të tij të gjerë dhe ndikimit në ndërkombëtarizim, në shkurt 2022, Prof. dr. Shefik Shehu u nominua nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Shkup për të marrë pjesë në Programin prestigjioz të Vizitorëve të Bashkimit Europian (EUVP). Ky është një program me prestigj i themeluar nga Parlamenti Europian dhe Komisioni Europian, i cili fton liderë aktualë dhe të ardhshëm nga vendet jashtë BE-së për vizita studimore të personalizuara. Vizita studimore i ka ofruar atij mundësinë për takime të nivelit të lartë me zyrtarë të BE-së, si dhe në selinë e NATO-s. Këto takime kanë shërbyer për të ndërtuar një kapital diplomatik për Universitetin e Tetovës, duke krijuar ura lidhëse mes botës akademike dhe asaj politikëbërëse.

Ndërkaq, në nëntor të vitit 2022, Prof. dr. Shefik Shehu u ftua si anëtar i jashtëm i komisionit të doktoraturës së kandidatës Sh. A, në Universitetin Autonom të Barcelonës. Kjo ftesë shënoi jo vetëm njohjen e thellë të ekspertizës së tij akademike në fushën përkatëse, por edhe forcimin e lidhjeve ndërkombëtare dhe praninë e tij në arenën shkencore europiane.

2. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Në vitin akademik 2008/2009 kandidati Shefik Shehu u angazhua si *asistent* në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Më 24. VI. 2010 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore *asistent* për lëndët mësimore në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës (Vendimi me nr. 02-3348/1 i datës 09. VII. 2010).

Më 04. V. 2016 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore *docent* për lëndët mësimore Hyrje në shkencat politike dhe Analiza e politikës së jashtme, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës (Vendimi me nr. 04-1698/1 i datës 19. V. 2016).

Më 25. I. 2020 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore *profesor inordinar* për lëndët mësimore Hyrje në shkencat politike dhe Analiza e politikës së jashtme, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës (Vendimi me nr. 13-48/1 i datës 25. I. 2021).

Angazhimi i tij pedagogjik nga viti akademik 2020/2021 deri në vitin akademik 2024/2025 si *profesor inordinar* manifestohet përmes një portofoli të gjerë dhe të larmishëm të lëndëve në të dyja ciklet e studimeve. Në ciklin e parë të studimeve, ai ligjëron lëndë themelore si: *Hyrje në shkencat politike, Analiza e politikës së jashtme dhe Politika e jashtme e SHBA-së*, si dhe kurse të specializuara në studimet evropiane si *Studime evropiane, Integrimi evropian dhe Siguria dhe politika e jashtme dhe e sigurisë e BE-së*. Portofoli i tij shtrihet edhe në fusha ndërdisiplinore në Fakultetin Filozofik me lëndë si *Vlerat evropiane dhe politika integruese, raca dhe përkatësia etnike: Një perspektivë globale dhe Sociologjia e vlerave evropiane*. Në ciklin e dytë të studimeve ai thellohet në tema të avancuara si *Gjeopolitika dhe zhvillimi i qëndrueshëm, Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë e BE-së dhe BE dhe gjeopolitika globale*.

Përveç ligjëratave dhe ushtrimeve, kandidati Prof. dr. Shefik Shehu, realizon dhe konsultime me studentët e Fakultetit Juridik, gjegjësisht programi studimor: Studime Politike, si dhe me studentët e Fakultetit Filozofik, gjegjësisht programet studimore: Sociologji dhe Punë Sociale dhe Mbrojtje Sociale.

2.1. Recensent i tekstit mësimor universitar

1. Universiteti i Tetovës, Monografi (1994/1995-2004/2005), Vëllimi I, Tetovë, 2021.
2. Drita M Fazlia, *Organizatata Ndërkombëtare*, Litera Group, 2023.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **Prof. dr. Shefik Shehu** ka realizuar gjithsej **106.9 pikë** nga **veprimtaria mësimore-arsimore**.

3. Veprimtaria shkencore-hulumtuuese:

a) Rezultatet shkencore të kandidatit që janë me rëndësi të veçantë për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore:

Veprimtaria kërkimore-shkencore e Prof. dr. Shefik Shehut karakterizohet nga një angazhim i thellë dhe i vazhdueshëm në analizimin e çështjeve komplekse që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare, studimet e sigurisë, proceset integruuese evropiane dhe kuadrin kushtetues. Puna e tij shtrihet nga analiza teorike e koncepteve themelore, si siguria e shteteve të vogla dhe idealet kantiane për paqe të përhershme, deri te studime specifike dhe aktuale mbi politikën e jashtme, arkitekturën evropiane të sigurisë dhe sfidat kushtetuese në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Botimet e tij pasqyrojnë një aftësi të veçantë për të lidhur debatet teorike globale me realitetet praktike rajonale, duke trajtuar tema si ndërhyrja e NATO-s në Kosovë nga perspektiva morale, promovimi i demokracisë si gurthemel i politikës së jashtme amerikane dhe diskursi mbi gjuhën e urrejtjes.

b) Pasqyra e punimeve shkencore, konferencave, seminareve në vend dhe jashtë vendit:

3.1. Punime shkencore të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare:

1. Leka, G., **Shehu, S.**, & Ibraimi, E. (2025). Analyzing North Macedonia's size and power in the context of its foreign policy conduct. *Academicus International Scientific Journal*.
2. Kamberi, D., & **Shehu, S.** (2024). The failure of European constitution. *Justicia International Journal of Legal Sciences*, 12(21-22), 65-69.
3. Ibraimi, E., Korbayram, A., & **Shehu, S.** (2024). Legal analysis of the procedure of constitutional amendment in the constitution of the Republic of North Macedonia and changes of the preamble through a constitutional amendment. *JUSTICIA International Journal of Legal Sciences*, 12(21-22), 177-184.
4. Kamberi, D., & **Shehu, S.** (2022). Was NATO intervention in Kosovo just in a moral point of view? Confronting approaches statism vs. cosmopolitanism. *Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication - FREEDOM*, 3(5-6), 13-18.
5. Kamberi, D., & **Shehu, S.** (2021). Open Balkan vs. Berlin Process– same, same but different?. *FREEDOM - Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication*, 2(3-4), 60-71.
6. Ahmeti, K., & **Shehu, S.** (2021). Kant's ideal of the world republic and perpetual peace. *FREEDOM - Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication*, 2(3-4), 14-20.
7. **Shehu, S.**, & Leka, G. (2020). Small states' security through international integrations: a theoretical approach. *JUSTICIA - International Journal of Legal Sciences*, 8(13-14), 199-206.
8. **Shehu, S.** (2020). Democracy promotion: the cornerstone of America's foreign policy after the cold war. *FREEDOM Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication*, 1(1-2), 26-30.
9. Ameti, V., Osmani Ballazhi, Sh., **Shehu, Sh.**, & Memishi Fejza, V. (2020). The role of food processing company employers in increasing quality in higher education. *International Journal of Food Technology and Nutrition*, 3(5-6), 9-14.

10. **Sh. Shehu**, *On University values and more*, prezantuar në The Aurora Spring Innsbruck Biannual: Taking stock and looking toward the future, 20 May 2022, Universiteti i Insbrukut, Austri.
11. Kamberi, D., & **Shehu, S.** *The twilight of international law and the collapse of agreements: understanding Russia's breach of international law in Ukraine*, prezantuar në "Law, Good Governance and Social Justice, 9th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 6-8.11.2024, Universiteti i Tetovës.
12. **Sh. Shehu** & E. Dervishi: *EU's foreign policy in the face of dynamic geopolitics: challenges and opportunities*, prezantuar në Navigating New Challenges: "Balkans at the Crossroads of EU Integrations, 8th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 15-17.11.2023, Universiteti i Tetovës.
13. **Sh. Shehu**, & Gj. Leka, 7 Th -International Scientific Conference of Law, titled: "The Western Balkans between the Russian influence and the European perspective",16-18.11.2022, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës.
14. **Sh. Shehu**, *The role of Universities in the future of the Balkans*, prezantuar në Dialogue and Cooperation in the Black Sea and Balkan Regions, organizuar nga BUA dhe BSUN, 12-15.10.2022, Universiteti i Bukureshtit, Rumani.
15. **Sh. Shehu**, *Illiberal Democracies and the Rule of Law*, Youth for Rule of Law Summer School, Center for Peace and Transcultural Communication, 30 qershor-4 korrik 2022, Tetovë.
16. **Sh. Shehu**, *Engines of Change: The Role of Balkan Universities in Advancing the Public Good*, ISCMP, Universiteti i Burdurit, Turqi, 29-01.10.2021.
17. **Sh. Shehu**, *Nga Marrëveshja e Ohrit drejt Demokracisë Konsociative: 20 Vjet Rrugëtim*, paraqitur në tribunën shkencore 20 vjet Përtej Ohrit, 30.07.2021, Universiteti i Tetovës.

3.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare:

1. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Tribunën Shkencore 20 vjet Përtej Ohrit, 30.07.2021, Universiteti i Tetovës.
2. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Youth for Rule of Law Summer School, Center for Peace and Transcultural Communication, 30 qershor-4 korrik 2022, Tetovë.
3. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në 9th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 6-8.11.2024, Universiteti i Tetovës.

3.3. Projekte/trajtime:

Prof. dr. Shefik Shehu ka një angazhim të thellë dhe të vazhdueshëm në projekte dhe iniciativa kërkimore ndërkombëtare, duke pasqyruar përkushtimin e tij individual ndaj shkencës dhe avancimit të njohurive. Përmes rolit të tij aktiv dhe ekspertizës së provuar, ai ka dhënë kontribute thelbësore, shpesh në pozicione kyçe që dëshmojnë lidhshpimin e tij shkencor.

1. Përfaqësues nacional, COST Action ENTER – EU Foreign Policy Facing New Realities (2018-2023) (2018-2023). Në cilësinë e përfaqësuesit kombëtar, Profesor Shehu bashkëpunoi aktivisht brenda këtij rrjeti të akademikëve duke marrë pjesë drejtpërdrejt në zhvillimin e analizave dhe formulimin e rekomandimeve mbi sfidat e reja të politikës së jashtme të BE-së, nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca, pritjes së studiuesve dhe ndjekjes së seminareve të specializuara.
2. Përfaqësues Ligjor i Entitetit të Emëruar (LEAR) i Universitetit të Tetovës (2019-)it të Tij: Ky rol përfshin menaxhimin e marrëdhënieve ligjore dhe administrative për të gjitha projektet e financuara nga Komisioni Evropian (Horizon Europe, Erasmus+, etj.), duke siguruar pajtueshmërinë dhe qëndrueshmërinë financiare të angazhimeve ndërkombëtare të universitetit.
3. Integrity and Anti-Corruption, Vrije Universiteit Amsterdam, AURORA, 2022, Pjesmarrës në aplikimin dhe zhvillimin e projektit të përbashkët të Fakultetit Juridik (UT) dhe Fakultetit Juridik/ Vrije Universiteit Amsterdam në kuadër të minigranteve që financoi Aleanca AURORA, 2022.
4. Koordinator universitar i programit CEEPUS në Universitetin e Tetovës (2019-2023).
5. Koordinator Institucional, Rrjeti CEEPUS CZ-0311-2425-184923 (deri në 2025).
6. Organizues i trajnimit Social Entrepreneurship & Diversity and Inclusion, AURORA CDS, Universiteti i Tetovës, 30-31 mars 2022.
7. Organizues i trajnimit Social Entrepreneurship & Diversity and Inclusion, AURORA CDS, Universiteti i Tetovës, 30-31 mars 2022.
8. Organizues i trajnimit Make it Stick: the Science of Successful Learning, Jim Lofton, Universiteti i Tetovës, 13-14 qershor 2023.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **Prof. dr. Shefik Shehu** ka realizuar gjithsej **115.3 pikë** nga **veprimtaria shkencore-hulumtuese**.

4. Veprimtaria profesionale-zbatuese:

4.1. Libër nga fusha profesionale

1. **Шефик Шеху:** „Помеѓу интеграција и (не)безбедност: Република Северна Македонија и Европската безбедносна архитектура“, Тетово, Чабеј Графика, 2025, ISBN 978-608-4819-64-6.

4.2. Kaptinë libri

1. **Shehu, S., & Leka, G.** (2020). HATE SPEECH: A NORMATIVE REFLECTION. Në V. Ameti (Eds.), *Hate speech during the election campaign of the 2020 parliamentary elections in the Republic of North Macedonia: the effects on the behavior of citizens in intergroup relations* (faqe 305-321). Tetovë: Universiteti i Tetovës.

4.3. Koordinator për përgatitjen e elaboratit të programit studimor të ri

1. Koordinator për përgatitjen e Elaboratit të programit studimor të ciklit të parë Studime Politike, viti 2020.
2. Koordinator për përgatitjen e Elaboratit të programit studimor të ciklit të dytë Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane, viti 2021.
3. Koordinator për përgatitjen e Elaboratit të programit studimor të ciklit të dytë Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, viti 2021.

4.4. Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit

1. Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Studime Politike për vitet akademike nga 2021 deri 2025.

4.5. Pjesëmarrje në projekte të realizuara

1. Përfaqësues nacional, COST Action ENTER – EU Foreign Policy Facing New Realities (2018-2023) (2018-2023).
2. Koordinator Institucional, Rrjeti CEEPUS (2018-2025)
3. Integrity and Anti-Corruption, Vrije Universiteit Amsterdam, AURORA, 2022
4. Koordinator Universitar i rrjeteve CEEPUS (2020-2023).
5. Organizues i trajnimit Make it Stick: the Science of Successful Learning, Jim Lofton, Universiteti i Tetovës, 13-14 qershor 2023.
6. Organizues i trajnimit Social Entrepreneurship & Diversity and Inclusion, AURORA CDS, Universiteti i Tetovës, 30-31 mars 2022.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **Prof. dr. Shefik Shehu** ka realizuar gjithsej **21.5 pikë** nga **veprimtaria profesionale-zbatuese**.

5. Veprimtari me interes më të gjerë:

5.1. Anëtar i këshillit redaktues të revistës shkencore / profesionale ndërkombëtare

1. *Justicia- International Journal of Legal Sciences*, University of Tetova, ISSN(Print): 1857-8454, ISSN (Online): 2545-4927.
2. *IJPS (International Journal of Politics and Security)*, Association of International Politics and Security (INTPOLSEC), ISSN: 2667-8268, e-ISSN: 2667-8268.
3. *Freedom - Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication*, ISSN (Print): 2671-3403, ISSN (Online): 2671-3411.

5.2. Anëtar i komisioneve në fakultet/universitet

1. Anëtar i Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve, viti akademik 2020/2021.
2. Anëtar i Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë të studimeve, viti akademik 2020/2021.
3. Kryetar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Universitetin e Tetovës, nga viti akademik 2020/2021 deri 2023/2024).
4. Anëtar i Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve, viti akademik 2021/2022.
5. Anëtar i Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë të studimeve, viti akademik 2021/2022.
6. Anëtar i Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve, viti akademik 2022/2023.
7. Anëtar i Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë të studimeve, viti akademik 2022/2023.
8. Anëtar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Universitetin e Tetovës, nga viti akademik 2023/2024 - vijim).

5.3. Qëndrim studimor në botën e jashtme

1. Istanbul University, Stamboll, 1 - 5 Nëntor 2021.
2. Canakkale Onsekiz Mart University, Canakale, 12 - 16 Shtator 2022.
3. University of Catania, Katania, 26 - 29 Prill 2023.
4. South-West University "Neofit Rilski", Blagoevgrad, 25 - 26 Maj 2023.
5. Istanbul University Stamboll, 23 - 27 Tetor 2023.
6. Institucionet e Bashkimit Evropian + NATO (EUVP Program) 31 janar-5 shkurt 2022.
7. Universiteti i Insbrukut, Austri, 10-12 maj 2022.
8. Universiteti i Bukureshtit, Rumani, 12-14 tetor 2022.
9. Universiteti Autonom i Barcelonës, 4-7 nëntor 2022.

5.4. Prorektor

1. Ushtrues detyre Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Universitetit të Tetovës (Vendimi me nr. 04-4498/1 i datës 02.XII. 2019).
2. Ushtrues detyre Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Universitetit të Tetovës (Vendimi me nr. 02-4322/1 i datës 2. XII. 2021).
3. Ushtrues detyre Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Universitetit të Tetovës (Vendimi me nr. 02-1586/1 i datës 30. V. 2022).
4. Ushtrues detyre Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Universitetit të Tetovës (Vendimi me nr. 04-1423/3 i datës 23. V. 2023).

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **Prof. dr. Shefik Shehu** ka realizuar gjithsej **22.5 pikë** nga **veprimtaria me interes më të gjerë**.

6. Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe njohjes personale të kandidatit, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-zbatuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati **Prof. dr. Shefik Shehu** posedon cilësi shkencore dhe profesionale sipas Ligjit për arsimin e lartë dhe Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në bashkëpunëtorë në Universitetin e Tetovës, nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, dhe ka grumbulluar **266.2 pikë** nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që janë të nevojshme për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **profesor ordinar**.

Bazuar në atë që u tha më lart, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, **Prof. dr. Shefik Shehu** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **profesor ordinar** në lëmin Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Diplomacia (5.06.00.06 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, korrik 2025

Komisioni recensues:

1. Prof. dr. Ylber SELA (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

2. Prof. dr. Drita MAMUTI-FAZLIA (anëtare) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

3. Prof. dr. Bashkim SELMANI (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË,
MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati: **Shefik Mushteba Shehu**

Institucioni: **Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomacia (5.06.00.06 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR-SHKENCOR - PROFESOR ORDINAR

Nr.	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Titulli shkencor - doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet Emri i sferës shkencore: Shkencat shoqërore (5) , fusha shkencore: Shkenca politike (5.06) , lëmia shkencore: Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomacia (5.06.00.06)	Po
2	Të publikuara së paku 6 (gjashtë) punime shkencore të recensuara ¹ në publikime shkencor referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po
2.1	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, të cilën do ta përcaktojë Këshilli Kombëtar për Arsimin të Lartë 1. Emri i revistës shkencore: <i>Academicus International Scientific Journal</i> 2. Emri i bazës elektronike të revistave: EBSCO, CEEOL 3. Titulli i punimit: <i>Analyzing North Macedonia's size and power in the context of its foreign policy conduct</i> 4. Data e publikimit: 2025	Po
2.2	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe të cilat kanë këshill redaktues në të cilin marrin pjesë anëtarë nga së paku tre shtete, me ç'rast numri i anëtarëve nga një vend nuk mund t'i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve	Po

¹ Për kandidatin/ët që ka publikuar më tepër se 6 (gjashtë) punime shkencore në publikime shkencore referente, komisioni recensues do t'i theksojë, vlerësojë me pikë dhe vendos në Formularin 2.

	<p>1. Emri i revistës shkencore: <i>Justicia - International Journal of Legal Sciences</i></p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): 57 anëtarë, 15 shtete</p> <p>3. Titulli i punimit: <i>Legal analysis of the procedure of constitutional amendment in the constitution of the Republic of North Macedonia and changes of the preamble through a constitutional amendment</i></p> <p>4. Data e publikimit: 2024</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <i>Justicia - International Journal of Legal Sciences</i></p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): 57 anëtarë, 15 shtete</p> <p>3. Titulli i punimit: <i>The failure of European Constitution</i></p> <p>4. Data e publikimit: 2024</p>	
3	<p>Libër mësimor i recensuar dhe publikuar, monografi, praktikum ose përmbledhje detyrash nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet**</p> <p>1. Titulli i librit mësimor, monografisë, praktikumit ose përmbledhjes së detyrave: <i>„Помеѓу интеграција и (не)безбедност: Република Северна Македонија и Европската Безбедносна Архитектура“</i></p> <p>2. Vendi dhe data e botimit: Tetovë, 2025</p>	Po
4	<p>Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë</p> <p>1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësisë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: Universiteti i Tetovës</p> <p>2. Lloji i trajnimit/përvoja/arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: Mësimdhënie</p> <p>3. Periudha e fitimit të shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: 2008-2025</p>	Po

** Kushti i theksuar do të zbatohet pas kalimit të tri viteve nga hyrja në fuqi e Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 82/2018).

FORMULARI 2

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE
MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Shefik Mushteba Shehu**

Institucioni: **Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomacia (5.06.00.06 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	Pikët
1	Mbajtja e ligjëratave (cikli i parë i studimeve)					39.6
1.1	Hyrje në shkencat politike (Studime Politike)	0.04	2	15	5	6
1.2	Analiza e politikës së jashtme (Studime Politike)	0.04	2	15	5	6
1.3	Studime evropiane (Studime Politike)	0.04	2	15	5	6
1.4	Politika dhe siguria e jashtme e BE-së (Studime Politike)	0.04	2	15	5	6
1.5	Politika e jashtme e SHBA-së (Studime Politike)	0.04	2	15	5	6
1.6	Integrimet në BE (Studime Politike)	0.04	2	15	5	6
1.7	Vlerat evropiane dhe politikat integrues (Filozofi me Edukim Qytetar)	0.04	2	15	1	1.2
1.8	Raca dhe përkatësia etnike: një perspektivë globale (Punë Sociale dhe Mbrojtje Sociale)	0.04	2	15	1	1.2
1.9	Sociologjia e vlerave evropiane (Sociologji)	0.04	2	15	1	1.2
2	Mbajtja e ushtrimeve (cikli i parë i studimeve)					29.7
2.1	Hyrje në shkencat politike (Studime Politike)	0.03	2	15	5	4.5
2.2	Analiza e politikës së jashtme (Studime Politike)	0.03	2	15	5	4.5
2.3	Studime evropiane (Studime Politike)	0.03	2	15	5	4.5
2.4	Politika dhe siguria e jashtme e BE-së (Studime Politike)	0.03	2	15	5	4.5
2.5	Politika e jashtme e SHBA-së (Studime Politike)	0.03	2	15	5	4.5
2.6	Integrimet në BE (Studime Politike)	0.03	2	15	5	4.5
2.7	Vlerat evropiane dhe politikat integrues (Filozofi me Edukim Qytetar)	0.03	2	15	1	0.9
2.8	Raca dhe përkatësia etnike: një perspektivë globale (Punë Sociale dhe Mbrojtje Sociale)	0.03	2	15	1	0.9
2.9	Sociologjia e vlerave evropiane (Sociologji)	0.03	2	15	1	0.9

3	Mbajtja e ligjëratave (cikli i dytë i studimeve)	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	12
3.1	Gjeopolitika dhe zhvillimi i qëndrueshëm (Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci)	0.05	2	10	4	4
3.2	Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë së BE-së (Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci)	0.05	2	10	4	4
3.3	BE dhe gjeopolitika globale (Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci)	0.05	2	10	4	4
4	Mbajtja e ushtrimeve (cikli i dytë i studimeve)	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	3.6
4.1	Gjeopolitika dhe zhvillimi i qëndrueshëm (Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci)	0.03	1	10	4	1.2
4.2	Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë së BE-së (Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci)	0.03	1	10	4	1.2
4.3	BE dhe hjeopolitika globale (Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci)	0.03	1	10	4	1.2
5	Përgatitja e lëndës së re					5
5.1	Sociologjia e vlerave evropiane (Sociologji)					1
5.2	Vlerat evropiane dhe politikat integrues (Filozofi me Edukim Qytetar)					1
5.3	Raca dhe përkatësia etnike: një perspektivë globale (Punë Sociale dhe Mbrojtje Sociale)					1
5.4	Gjeopolitika e resurseve agrare (Agrobiznes)					1
5.5	Politika globale e ushqimit (Agrobiznes)					1
6	Konsultime me studentët					1
6.1	Konsultimet me studentë		50x10x0.002			1
7	Mentorim					6
7.1	Mentor i temave të diplomës		15 x 0.2			3
7.2	Mentor i temave të magistraturës		3 x 1			3
8	Anëtar i komisioneve					8
8.1	Anëtar komisioni për vlerësim dhe mbrojtjen të punimit të diplomës		30x0.1			3
8.2	Anëtar i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të magistraturës		5x0.3			1.5
8.3	Anëtar i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të doktoratës		5x0.5			2.5
8.4	Kryetar i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të doktoratës		1			1
9	Recensent i librit mësimor universitar					2
9.1	Universiteti i Tetovës, Monografi (1994/1995-2004/2005), Vëllimi I, Tetovë, 2021					1
9.2	Drita M Fazlia, <i>Organizatrat Ndërkombëtare</i> , Litera Group, 2023					1
Gjithsej (1+2+3+4+5+6+7+8+9)						106.9

II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Teza të mbrojtura	12
1.1	„Maqedonia dhe strategjia evropiane e sigurisë: Roli i Maqedonisë në sigurinë e Bashkimit Evropian“, – teza e doktoratës, Instituti për Studime të Mbrojtjes dhe Paqes në kuadër të Fakultetit Filozofik të Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ në Shkup	8
1.2	„Marrëveshja e Ohrit: Rrugë drejt Integrit apo Shpërbërjes?“, – teza e magistraturës, Institutin për Studime Evropiane dhe Ndërkombëtare në Hungari	4
2	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale	81.3
2.1	Leka, G., Shehu, S. , & Ibraimi, E. (2025). Analyzing North Macedonia's size and power in the context of its foreign policy conduct. <i>Academicus International Scientific Journal</i>	6x0.8= 4.8
2.2	Kamperi, D., & Shehu, S. (2024). The failure of European constitution. <i>Justicia International Journal of Legal Sciences</i> , 12(21-22), 65-69	5x0.9= 4.5
2.3	Ibraimi, E., Korbayram, A., & Shehu, S. (2024). Legal analysis of the procedure of constitutional amendment in the constitution of the Republic of North Macedonia and changes of the preamble through a constitutional amendment. <i>JUSTICIA International Journal of Legal Sciences</i> , 12(21-22), 177-184	5x0.8=4
2.4	Kamperi, D., & Shehu, S. (2022). Was NATO intervention in Kosovo just in a moral point of view? Confronting approaches statism vs. cosmopolitanism. <i>Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication - FREEDOM</i> , 3(5-6), 13-18	5x0.9= 4.5
2.5	Kamperi, D., & Shehu, S. (2021). Open Balkan vs. Berlin Process– same, same but different?. <i>FREEDOM - Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication</i> , 2(3-4), 60-71	5x0.9= 4.5
2.6	Ahmeti, K., & Shehu, S. (2021). Kant's ideal of the world republic and perpetual peace. <i>FREEDOM - Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication</i> , 2(3-4), 14-20	5x0.9= 4.5
2.7	Shehu, S. , & Leka, G. (2020). Small states' security through international integrations: a theoretical approach. <i>JUSTICIA - International Journal of Legal Sciences</i> , 8(13-14), 199-206	5x0.9= 4.5
2.8	Shehu, S. (2020). Democracy promotion: the cornerstone of America's foreign policy after the cold war. <i>FREEDOM Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication</i> , 1(1-2), 26-30	5
2.9	Ameti, V., Osmani Ballazhi, Sh., Shehu, Sh. , & Memishi Fejza, V. (2020). The role of food processing company employers in increasing quality in higher education. <i>International Journal of Food Technology and Nutrition</i> , 3(5-6), 9-14	5x0.7= 3.5
2.10	Sh. Shehu , <i>On University values and more</i> , prezantuar në The Aurora Spring Innsbruck Biannual: Taking stock and looking toward the future, 20 May 2022, Universiteti i Insbrukut, Austri	6
2.11	Kamperi, D., & Shehu, S. <i>The twilight of international law and the collapse of agreements: understanding Russia's breach of international law in Ukraine</i> , prezantuar në "Law, Good Governance and Social Justice, 9 th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 6-8.11.2024, Universiteti i Tetovës	5x0.9= 4.5
2.12	Sh. Shehu & E. Dervishi: <i>EU's foreign policy in the face of dynamic geopolitics: challenges and opportunities</i> , prezantuar në Navigating New Challenges: "Balkans at the Crossroads of EU Integrations, 8th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 15-17.11.2023, Universiteti i Tetovës	5x0.9= 4.5
2.13	Sh. Shehu , & Gj. Leka, 7 Th -International Scientific Conference of Law, titled: "The Western Balkans between the Russian influence and the European perspective", 16-18.11.2022, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës	5x0.9= 4.5

2.14	Sh. Shehu , <i>The role of Universities in the future of the Balkans</i> , prezantuar në Dialogue and Cooperation in the Black Sea and Balkan Regions, organizuar nga BUA dhe BSUN, 12-15.10.2022, Universiteti i Bukureshtit, Rumani	6
2.15	Sh. Shehu , <i>Illiberal Democracies and the Rule of Law</i> , Youth for Rule of Law Summer School, Center for Peace and Transcultural Communication, 30 qershor-4 korrik 2022, Tetovë	5
2.16	Sh. Shehu , <i>Engines of Change: The Role of Balkan Universities in Advancing the Public Good</i> , ISCMP, Universiteti i Burdurit, Turqi, 29-01.10.2021	6
2.17	Sh. Shehu , <i>Nga Marrëveshja e Ohrit drejt Demokracisë Konsociative: 20 Vjet Rrugëtim</i> , paraqitur në tribunën shkencore 20 vjet Përtej Ohrit, 30.07.2021, Universiteti i Tetovës.	5
3	Pjesëmarrje në takim shkencor / profesional me prezantim oral	14
3.1	Sh. Shehu , On University values and more, prezantuar në The Aurora Spring Innsbruck Biannual: Taking stock and looking toward the future, 20 May 2022, Universiteti i Insbrukut, Austri	2
3.2	D. Kamberi, Sh. Shehu , <i>The twilight of international law and the collapse of agreements: understanding Russia's breach of international law in Ukraine</i> , prezantuar në "Law, Good Governance and Social Justice, 9 th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 6-8.11.2024, Universiteti i Tetovës	2
3.3	Sh. Shehu , E. Dervishi: <i>EU's foreign policy in the face of dynamic geopolitics: challenges and opportunities</i> , prezantuar në Navigating New Challenges: "Balkans at the Crossroads of EU Integrations, 8th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 15-17.11.2023, Universiteti i Tetovës	2
3.4	Sh. Shehu , <i>The role of universities in the future of the Balkans</i> , prezantuar në Dialogue and Cooperation in the Black Sea and Balkan Regions, organizuar nga BUA dhe BSUN, 12-15.10.2022, Universiteti i Bukureshtit, Rumani	2
3.5	Sh. Shehu , <i>Illiberal Democracies and the Rule of Law</i> , Youth for Rule of Law Summer School, Center for Peace and Transcultural Communication, 30 qershor-4 korrik 2022, Tetovë	2
3.6	Sh. Shehu , <i>Engines of Change: The Role of Balkan Universities in Advancing the Public Good</i> , ISCMP, Universiteti i Burdurit, Turqi, 29-01.10.2021	2
3.7	Sh. Shehu , <i>Nga Marrëveshja e Ohrit drejt Demokracisë Konsociative: 20 Vjet Rrugëtim</i> , paraqitur në tribunën shkencore 20 vjet Përtej Ohrit, 30.07.2021, Universiteti i Tetovës	2
4	Certifikata për pjesëmarrje në konferenca shkencore	6
4.1	Certifikatë për pjesëmarrje në Tribunën Shkencore 20 vjet Përtej Ohrit , 30.07.2021, Universiteti i Tetovës	2
4.2	Certifikatë për pjesëmarrje në Youth for Rule of Law Summer School, Center for Peace and Transcultural Communication, 30 qershor-4 korrik 2022, Tetovë	2
4.3	Certifikatë për pjesëmarrjen në 9 th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 6-8.11.2024, Universiteti i Tetovës	2
5	Abstrakt i botuar në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare	2
5.1	D. Kamberi, Sh. Shehu , <i>The twilight of international law and the collapse of agreements: understanding Russia's breach of international law in Ukraine</i> , 9 th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 6-8.11.2024, University of Tetova	1
5.2	Sh. Shehu , E. Dervishi: <i>EU's foreign policy in the face of dynamic geopolitics: challenges and opportunities</i> , prezantuar në Navigating New Challenges: "Balkans at the Crossroads of EU Integrations, 8th International Scientific Conference of the Faculty of Law	1
Gjithsej (1+2+3+4+5)		115.3

III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Libra nga fusha profesionale	8
1.1	Шефик Шеху: „Помеѓу интеграција и (не)безбедност: Република Северна Македонија и Европската безбедносна архитектура“, Тетово, Чабеј Графика, 2025, ISBN 978-608-4819-64-6	8
2	Картинë nga libri	2
2.1	Shehu, S., & Leka, G. (2020). HATE SPEECH: A NORMATIVE REFLECTION. Në V. Ameti (Eds.), <i>Hate speech during the election campaign of the 2020 parliamentary elections in the Republic of North Macedonia: the effects on the behavior of citizens in intergroup relations</i> (faqe 305-321). Tetovë: Universiteti i Tetovës	2
3	Koordinator për përgatitjen e elaboratit për programi studimor të ri	3
3.1	Koordinator për përgatitjen e Elaboratit të programit studimor të ciklit të parë Studime Politike, viti 2020	1
3.2	Koordinator për përgatitjen e Elaboratit të programit studimor të ciklit të dytë Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane, viti 2021	1
3.3	Koordinator për përgatitjen e Elaboratit të programit studimor të ciklit të dytë Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, viti 2021	1
4	Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit	2.5
4.1	Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Studime Politike për vitet akademike nga 2021 deri 2025	0.5x5= 2.5
5	Projekt realizues	6
5.1	Përfaqësues nacional, COST Action ENTER – EU Foreign Policy Facing New Realities (2018-2023) (2018-2023)	1
5.2	Koordinator Institucional, Rrjeti CEEPUS (2018-2025)	1
5.3	Integrity and Anti-Corruption, Vrije Universiteit Amsterdam, AURORA, 2022	1
5.4	Koordinator Universitar i rrjeteve CEEPUS (2020-2023)	1
5.5	Organizues i trajnimit Make it Stick: the Science of Successful Learning, Jim Lofton, Universiteti i Tetovës, 13-14 qershor 2023	1
5.6	Organizues i trajnimit Social Entrepreneurship & Diversity and Inclusion, AURORA CDS, Universiteti i Tetovës, 30-31 mars 2022	1
Gjithsej (1+2+3+4+5)		21.5

IV. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Anëtar i këshillit redaktues të revistës ndërkombëtare shkencore/profesionale	3
1.1	Justicia- <i>International Journal of Legal Sciences</i> , University of Tetova, ISSN(Print): 1857-8454, ISSN (Online): 2545-4927	1
1.2	IJPS (International Journal of Politics and Security), Association of International Politics and Security (INTPOLSEC), ISSN: 2667-8268, e-ISSN: 2667-8268	1
1.3	Freedom - <i>Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication</i> , ISSN (Print): 2671-3403, ISSN (Online): 2671-3411	1
2	Anëtar i komisioneve në fakultet/universitet	8
2.1	Anëtar i Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve, viti akademik 2020/2021	1
2.2	Anëtar i Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë të studimeve, viti akademik 2020/2021	1
2.3	Kryetar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Universitetin e Tetovës, nga viti akademik 2020/2021 deri 2023/2024)	1
2.4	Anëtar i Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve, viti akademik 2021/2022	1
